



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:048026

Datë: 31.08.2018

Numri i dokumentit: 00110793

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIM ËSHTË I PLOTËFUNDISHËM
QËNDRIM I PRAVNOSHTËSIA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UKOŠEVAC

Më
Datë

13. 12. 2018

P. nr.3300/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Hysnije Gashi dhe zyrtare ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] K. Ferizaj dhe [REDACTED] për shkak secili veç e veç të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par 1 lidhur me 28 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP./II.nr.34/17 e datës 27 dhjetor 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 07.06.2018, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini të pandehurit [REDACTED] të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.30.08.2018, përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

Të pandehurit:

1. [REDACTED], i lindur më [REDACTED] në fshatin [REDACTED], K Ferizaj nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] me vendbanim [REDACTED], me numër personal [REDACTED], i martuar baba i katë fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2. [REDAKTUAR], i lindur më [REDAKTUAR] në fshatin [REDAKTUAR], K Ferizaj nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] me vendbanim [REDAKTUAR] me numër personal [REDAKTUAR] i martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse :

Më datën 24.01.2017 rreth orës 23:30, në kazinon "Matrix", e cila gjendet në fshatin Talinocë i Muhaxhereve në Ferizaj, duke i fshehur faktet, kanë tentuar të mashtrorjnë të dëmtuarin [REDAKTUAR] me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, në atë mënyrë që i pandehuri [REDAKTUAR] me herët i ka blerë 10 kartëmonedha nga 50 €, dhe pastaj ja ka dhënë të pandehurit [REDAKTUAR] 3 kartëmonedha nga 50 €, kurse 7 kartëmonedha i ka mbajtur vet, kurse ditën kritike kanë shkuar në kazinon e përmendur më lartë, me qëllim që ti ndërrojnë me para të pa dëmtuara, me qrast kanë futur në aparat një kartëmonedhë prej 50 €, e pastaj kanë kërkuar nga pronari që t'ia jap një kartëmonedhë tjetër prej 50 €, me arsyetimin se dëshirojnë të luajnë në një aparat tjetër, mirëpo i dëmtuari ka dyshuar se paratë janë të falsifikuara dhe ka njoftuar policinë e cila, i ka sekuestruar paratë përkohësisht,

- me këtë secili veç e veç ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 28, 41, 42, 43, 46, 49, dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, i shqipton këtë:

G J Y K O N

DËNIM ME KUSHT dhe ME GJOBE

1. Te Akuzuarin [REDAKTUAR]
DENIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 1 (një) Viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 /një/ vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale .

- **DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200/** dyqind euro/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj nga një ditë burgimi

Të akuzuarin [REDAKTUAR]

DENIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 1(një) Viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 /një/ vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale .

- **DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200/** dyqind euro/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj nga një ditë burgimi

I dëmtuari [REDAKTUAR] per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të akuzuarit që secili veç e veç ne emër te shpenzimeve te procedurës te paguaj shumën prej 20€ /njëzet euro/, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Detyrohen të akuzuarit që secili veç e veç që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP./II.nr.2112-5/2017 e datës 04 dhjetor 2017 ka akuzuar të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për shkak se secili veç e veç veprën penale mashtrimi nga neni 335 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.30.08.2018, gjatë së cilës u dëgjuan prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe mbrojtësi i të pandehurit [REDAKTUAR] av. [REDAKTUAR]

I pandehuri [REDAKTUAR] në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e njoftimit nga gjyqtarja për drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së ka deklaruar se ne konsultim me mbrojtësin e tij Av [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale të kësaj natyre, dhe i propozon gjykatës që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

I pandehuri [REDAKTUAR] në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e njoftimit nga gjyqtarja për drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale të kësaj natyre, dhe i propozon gjykatës që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, në fjalën e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: konform nenit 248

par. 4 të KPPRK-së i propozon gjykatës që me aktvendim ta pranon fajësinë nga ana e të akuzuarit dhe menjëherë të vazhdoj me shqiptimin e dënimit meritor, njëherit pranimin e fajësisë së të njëjtit ta merrni si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit meritor-ligjor.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri.

pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç janë vërtetimi për sekuestrimin e sendeve i datës 21.01.2017 dhe te datës 24.01.2017, Raporti i ekspertimit i AKF-së me numër AKF/2017-0265/2017-240 i datës 03.02.2017.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të akuzuarit [REDAKTUAR] Av [REDAKTUAR] dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par. 4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të pandehurve përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtor.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të pandehurin [REDAKTUAR] gjeti faktin se gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndien shumë keqardhje për veprimet e tij për të cilët edhe kërkuan falje, gjendjen e tij familjare dhe ekonomike dhe se vepra penale ka mbetur në tentativë

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të pandehurin [REDAKTUAR] gjeti faktin, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, është i moshës së re ishte i sinqertë gjatë gjykimit,

dhe ndien shumë keqardhje për veprimet e tij për të cilët edhe kërkuan falje, gjendjen e tij familjare dhe ekonomike dhe se vepra penale ka mbetur ne tentativë

Duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve , gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 par. 1 të KPK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u murrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ


Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal

P.nr.3300/17 dt. 30.08.2018

Zyrtare ligjore,
Albana Ujupi

Gjyqtarja,

Hysnije Gashi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit , Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.

P.nr.3300/17

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i pergjithshem – divizioni penal, sipas gjyqtares Hysnije Gashi, me Zyrtaren Ligjore Albana Ujupi , duke vendosur ne çështjen penale ndaj te akuzuarëve: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për shkak te veprës penale se secili veq e veq mashtrimi nga neni 335 par 1 lidhur me 28 te KPK-së, më datë 13.12.2018 merr këtë:

AKTVENDIM

Përmirësues

PERMIRESOHT Aktgjykimi i kësaj Gjykate P.nr.3300/17 datës 30.08.2018, ashtu qe ne hyrje te këtij Aktgjykimi duhet te hiqet emri i te pandehurit [REDAKTUAR] nërkaq pjesët tjera të Aktgjykimit të mbeten te pa prekura-pa ndryshuara.

Arsyetimi

Në aktgjykimin e e kësaj Gjykate P.nr.3300/17 datës 30.08.2018 është bërë gabim teknik ashtu qe ne hyrje te këtij Aktgjykimi duhet te hiqet emri i te pandehurit [REDAKTUAR] nërkaq pjesët tjera të Aktgjykimit të mbeten te pa prekura-pa ndryshuara.

Ky lëshim teknik është vërejtur nga ana e gjyqtarit te vetëm gjykues më datë 13.12.2018 dhe është përmirësuar duke u bazuar ne nenin duke u bazuar ne nenin 371 te KPPK-se.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i pergjithshëm

P.nr .3300/17 më 13.12.2018

Zyrtare Ligjore,
Albana Ujupi

